

Aq të rëndësishme e ka Kryeministri ndryshimin e sotëm kushtetues, sa që pothuajse gjithë kohës nuk ka qenë në sallë. Erdhi vetëm për shown e radhës, kur takoi tri zonja të nderuara përfaqësues të banorëve të “5 Majit”, Laprakës, Paskuqanit e të tjerë, të cilëve po u shemb shtëpitë pikërisht në shkelje flagrante të dokumentit që po diskutojmë sot. Në fakt, edhe diskutimi ynë në këtë orë të ditës nuk ka më sens, sepse është votuar. Se si mund të diskutohet pas votimit, kjo vetëm në këtë parlament mund të ndodhë. Dhe votimi bëhet me urdhër, në katër e gjysmë. Apo ashtu ishte një muhabet? Sepse s’duhej të prishej ai pazari i orëve të vona të natës, kështu që duhej votuar në orën katër e gjysmë. Pse jo në orën pesë? Pse jo në orën gjashtë? Pse jo pasi të kenë mbaruar të gjitha diskutimet? Në fund të fundit, për çfarë po diskutojmë? Çfarë vlere ka diskutimi ynë, nëse nuk merret parasysh? Gjithsesi, në respekt të qytetarëve, të cilët na kanë besuar votën e tyre, unë do ta lexoj fjalën që kam përgatitur në lidhje me ndryshimet kushtetuese, që na propozohen sot. Këtë do ta bëj pavarësisht se disa miq të mi të mirë më sugjeruan, më këshilluan, që sot të mos e merrja fjalën.

Për fat të keq, ditë si kjo e sotmja, seanca si kjo e sotmja, në vend që të vendosin në të mirë të publikut e të qytetarëve, shfrytëzohen nga shumë deputetë, të cilët janë apo nuk janë tani, në këtë çast, për përfitime personale, për koncesione, për promovime, për tregti votash. Shumica në këtë sallë mendon vetëm për vete e pakkush për ata që na kanë besuar votën jo një herë, por që enden e rropaten prej vitesh nga një derë gjykate në tjetrën, pa pasur as aksesin në drejtësinë që duan. E nëse nuk flasim sot, atëherë kur, kur do të flasim? E nëse nuk flasim për drejtësinë, atëherë për çfarë duhet të flasim? Nëse nuk flasim për drejtësinë e munguar dhe të drejtat e nëpërkëmbura të qytetarëve, atëherë as unë nuk meritoj besimin dhe votën e tyre. Që në nisje, dua ta shpreh qartësisht qëndrimin tim: po, unë jam pro reformës në drejtësi. Po, unë jam për përfundimin e këtij procesi. Ka nisur dhe duhet të përfundojë. Nuk është logjike të ndërpritet. Duhet përfunduar ajo, të cilën e kemi nisur 5 vjet më parë. Unë e kam votuar ndryshimin kushtetues për procesin e vetingut, ashtu si 139 deputetët e tjerë. Që në nisje dua qartësisht të them qëndrimin tim, për të mos u lënë shkas devijimeve të qëndrimeve të mia më pas. Unë jam një nga votueset e ndryshimeve kushtetuese para 5 vjetëve e gjysmë. Sot, 5 vjet e gjysmë nga reforma që unë e votova, si çdo shqiptari, pyetjet që më lindin janë të shumta: çfarë është bërë me vetingun? A ka qenë ai i suksesshëm? Sa i shërbeu reformës në drejtësi? A është bërë një analizë e reformës në drejtësi? A ka ecur mirë, apo ka ecur keq? Çfarë nuk është bërë ashtu siç duhet? Çfarë duhet bërë më mirë? Po si do të bëhet më mirë? Çfarë mendojnë shqiptarët për reformën në drejtësi? A e besojnë atë? A besojnë te drejtësia e re? Të gjithë e dimë që jo. Nuk besojnë tek ajo, sepse, pavarësisht çfarë trumbetohet, ata nuk po marrin drejtësi.

Sot po kërkohet që të bëhen ndryshime, pa bërë një analizë për një proces që ka qenë dështim në çdo aspekt, një proces i keqplanifikuar, një proces që paralizoi drejtësinë, sepse ata, që e hartuan, ishin krejt dritëshkurtër. Sot po kërkohet që të bëhen ndryshime pa bërë një analizë të një procesi, i cili ka shkaktuar probleme serioze; ka qenë një proces selektiv, që shërbyer për kapjen e drejtësisë, një proces që ka qenë një dështim total në planifikim, organizim dhe zbatim. Standardet në proces kanë qenë të shumëfishta. Gjyqtarët e prokurorët, që u kanë shërbyer interesave të maxhorancës, e kanë kaluar vetingun, pavarësisht se kanë pasur probleme të ngjashme ose edhe më të rënda se kolegët e tyre të shkarkuar, kanë larguar njerëz për dy lekë dhe janë mbajtur milionerë të korruptuar vetëm se i shërbejnë pushtetit. Ka qenë një proces që ka larguar disa të korruptuar, por, mbi të gjitha, ka larguar ata që nuk i shërbejnë pushtetit socialist dhe që janë perceptuar si të djathtë. U prodhuan një SPAK, i cili vijon të mos ketë guximin minimal përballë korrupsionit të rëndë e të dukshëm qeveritar. Ka

dhjetëra dosje që ende presin për t'u hetuar nga SPAK-u. Ka pasur emërime të personave të lidhur ngushtë e familjarisht me maxhorancën. Reforma e miratuar me 140 vota u zbatua në mënyrën më të keqe të mundshme. Gjyqësori është në krize të thellë burimesh njerëzore, të cilat dëmtojnë në mënyrë fatale mundësinë e qytetarëve të marrin drejtësi. I tërë sistemi gjyqësor është në kolaps. Ka mungesa në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Shkalla e parë është e supernrgarkuar dhe ka vonesa në gjykime. Apeli pothuajse nuk funksionon. Gjykata e Lartë ka 35 mijë dosje të pashqyrtuara. Një familjar imi ka një çështje në Gjykatën e Lartë që prej janarit të vitit 2014 dhe ende nuk ka asnjë shans për gjykim. Sot ka ende dy lloje gjykatësish: të parët që e dinë se nuk do ta kalojnë vetingun e po shfrytëzojnë ditët e fundit për të vjelë mGjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, pasi qëndruan më shume se dy vjet në kolaps, tani janë me staf të kufizuar gjyqtarësh. Kush mban përgjegjësi që nuk kishim Gjykatë Kushtetuese për 3 vjet?

Sa vendime, sa projektligje, sa ligje antikushtetuese janë miratuar? Ka komisionerë të vetingut që nuk kanë treguar integritet profesional dhe një pjesë e tyre kanë vetë probleme me pasurinë apo aftësitë profesionale. Por sot askush nuk u kërkon falje qytetarëve, askush nuk thotë pse dhe ku u gabua dhe ata, që e kanë hartuar, nuk kanë asnjë shenjë reflektimi, askush nuk bën një analizë para qytetarëve shqiptarë. Sot në Shqipëri nuk ka drejtësi. Unë kam bërë betejat e mia për shëndetësinë e rrënuar prej koncepcioneve, PPP-ve, tenderëve abuzivë, jo vetëm me kosto financiare, por edhe humane! Ku është sot Ilir Beqja? Nuk mjaftuan paratë e buxhetit, i dhanë edhe ato të donatorëve. Kam bërë betejën për Teatrin Kombëtar, pak prej nesh këtu e kishin pasur të sinqertë. Teatri, si vlerë e rrallë e trashëgimisë kulturore historike, politike, artistike, arkitektonike, u shemb. Ku janë përgjegjësit?! Njëri Kryeministër, tjetri kryetar bashkie, tjetri deputet, askush nuk ka shkuar para drejtësisë. Thanë fitore se u dënua Saimir Tahiri 3 vjet e 4 muaj! Shumë pak për atë që lejoi kanabizimin e Shqipërisë dhe e riktheu Shqipërinë në të gjitha hartat e zeza të krimit të organizuar, trafikut, pastrimit të parave. Sa shqiptarë po vuajnë sot pasojat e përdorimit të parave të pista në ekonomi? A është vënë drejtësi për banorët e Bregut të Lumit, të cilëve iu hodh gaz brenda shtëpive, u hodhën nga çatitë dhe iu shemb për 5 minuta mundi i 30 vjetëve? A po bëhet drejtësi me banorët "5 Majit", Laprakës, Paskuqanit, që po sulmohen si të ishin armiq e në shkelje të çdo konvente e çdo ligji? Nëse drejtësia e re do të kishte funksionuar, a do të kishim masakër elektorale më 25 prill? A do të kishim sistem perfekt patronazhimi që dhuron të drejtën kushtetuese për votën e lirë? A do të kishim rrjedhje të të dhënave personale e askush s'mban përgjegjësi? A do t'i përdornin Manastirliu e Ulsiu punonjësit e administratës publike si patronazhiste?

Nëse Ilir Beqja do ishte para përgjegjësisë, a do të vidhej sot me tenderët sekretë, me ilaçet dhe respiratorët, pajisjet mbrojtëse, maskat? Nëse do të funksiononte drejtësia e re, a do të mbante dikush përgjegjësi për 16 mijë raste humbje jetësh, më shumë se mesatarja e viteve të fundit, apo për korrupsionin që ka shkatërruar çdo shtyllë të shëndetësisë? Nëse do të funksiononte drejtësia e re, mund të vazhdoja gjatë. Procesi i vetingut është shumë i rëndësishëm dhe duhet të vijojë, por jo siç është bërë këta 5 vjet, duke ulur besimin e opinionit publik te reforma në drejtësi. Vetingu duhet të përfundojë e do të përfundojë, por është proces që ka nevojë të analizohet, të rishikohet, të nxirren gabimet, pastaj të reformohet. Vetëm kështu mund të jetë në shërbim të qytetarëve e të pushtetarëve. Drejtësia nuk duhet parë si çështje pazari e ditës, por çështje jetike e shoqërisë shqiptare. Ju faleminderit!